

SHTOJCA NR. 5

DEKLARATË

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, lindur më \_\_\_\_\_,  
me kartë identiteti, pasaportë nr. \_\_\_\_\_,

1. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë \_\_\_\_\_, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore, për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin eventual të tyre. Autorizoj, gjithashtu, institucionin e arsimit të lartë ku ka kam aplikuar, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore, për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve, lidhur me: studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër.

2. Deklaroj se do të regjistrohem vetëm në një nga programet e studimit në të cilin do të shpallej fitues, për vitin akademik 2018–2019.

3. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

4. Deklaroj se jam njohur në momentin e aplikimit me kriteret e pranimit në programin e studimit, si dhe pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi dhe jam dakord për sa më sipër.

5. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe dhe/ose Qendra e Shërbimeve Arsimore, dhe/ose LAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre, duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

\_\_\_\_\_  
Emër, atësi, mbiemër i kandidatit

\_\_\_\_\_  
Emër, atësi, mbiemër i punonjësit të sekretarisë mësimore

Firma:

Firma:

Vendi: \_\_\_\_\_

Data: \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . \_\_\_\_\_